



Organization for Security and Co-operation in Europe

Zvicerani Tim Guldumann Shef i ri i misionit të OSBE-së në Kosovë

VJENË, 1 tetor 2007 – Tim Guldumann nga Zvicra ka marrë sot postin e Shefit të misionit të OSBE-së në Kosovë.

Emërimi i Guldumann shënon kthimin e tij në shërbim të OSBE-së; ai ishte shef i misionit të OSBE-së në Kroaci nga viti 1997 deri në 1999, dhe ka udhëhequr Grupin për Asistim të OSBE-së në Çeçeni nga viti 1996 deri në 1997.

Para këtij posti ai ka ligjëruar në një numër universitetesh në Europë, siç janë: Universiteti i Frankfurtit, Universiteti i Bernit dhe Kolegji i Europës në Bryzh dhe Varshavë. Nga viti 1999 deri 2004 ai ka shërbyer si Ambasador i Zvicrës në Teheran. Guldumann iu ka bashkangjitur shërbimit diplomatik zviceran në vitin 1982.

Guldumann trashëgon postin e Werner Wnendt, i cili ka shërbyer si Shef i misionit në Kosovë nga viti 2005 deri në 2007.

Misioni i OSBE-së në Kosovë më i madhi në rajon është themeluar nga Këshilli i Përhershëm i OSBE-së më 1 korrik 1999. OSBE-ja është shtylla e III-të për Demokratizim dhe Ndërtim të Institucioneve nën kornizën operative të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK).